



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi
Mbledhja nr. 32
Prishtinë, më 5 tetor 2009, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C - 203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Ibrahim Makolli, Mufera Şinik dhe Kolë Berisha-anëtarë .

Munguan: Selvije Halimi dhe Vladimir Todoroviq.

Të ftuar: Nekibe Kelmendi – ministre e Drejtësisë.

Të pranishëm: Mentor Borovci – AKK, Arben Krasniqi – ZK, Georgi Rupchev – EU-AC – projekt, Rrezarta Ahmeti - KDI, Lendita Kastrati – EU - AC- projekt, Petrit Hysaj – OSBE, Fatbardhë Zeka – Bota sot, Mendolije Krelani - Zëri, Reshit Gashi - NDI, Sylë Ahmeti – Kosova Sot dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga Staf i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 14 shtatorit 2009;
3. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-151/k të datës 22 shtator 2009, lidhur me plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës;
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin kundër korrupsionit;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshim, të fillohet me pikën e katërt të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 14 shtatorit 2009
Procesverbali u miratua pa vërejtje.

Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin kundër korrupsionit

Kryetari i përshëndeti të pranishmit dhe ata që e mbikëqyrin punën e Komisionit. E ftoi Ibrahim Makollin ta merrte fjalën, si kryesues i Nënkomisionit për shqyrtimin e Projektligjit kundër korrupsionit. Lidhur me propozimamendamentet e nxjerra, në mënyrë që të procedohen më tutje.

Ibrahim Makolli e njoftoi Komisionin për propozimamendamentet e nxjerra nga Nënkomisioni, duke i paraqitur ato për miratim nga ana e Komisionit.

Armend Zemaj -Propozoi që amendamentet e nxjerra nga Nënkomisioni të përkraken me disa vërejtje të vogla teknike, me përjashtim të amendamentit 5 ,neni 6 “ *të shqyrtohet në Komision*”. Ky amendament duhet të shikohet me vëmendje, sepse mund të bjerë ndesh me ligjet e tjera, sidomos me Ligjin për pagat dhe me Ligjin për shërbyesit civilë.

Bajram Kosumi -Lidhur me propozimamendamentin 5, neni 6, ishte i mendimit se do të duhej të parashihej në ligj edhe rrezikshmëria e punëtorëve të Agjencisë, në mënyrë që pagat të jenë në nivel të përshtatshëm për punën e tyre.

Pas paraqitjes së propozimamendamenteve nga Ibrahim Makolli, kryesues i Nënkomisionit, u miratuan amendamentet 1,2,3,7,8,10, ndërsa në amendamentin 4, neni 5, pika 5, në vend të fjalës “përgatit” të jetë “*harton* “. Propozim amendamenti 5, neni 6, nuk miratohet nga Komisioni.

Propozimamendamenti 7, neni 8, miratohet me përmirësim që të shtohet “ *4 -vjeçare ose master*”, propozimamendamenti 9, neni 11, pika 7, hiqet. Amendamenti 11, neni 13.1, riformulohet, ndërsa paragrafët 2 dhe 3 hiqen. Amendamenti 12, neni 14, në vend të fjalës aprovon të jetë “ *rekomandon*”.

Propozimamendamentet 13,14,15, 16, 17 dhe 18 të mbeten për t’u shqyrtuar në një nga mbledhjet e radhës.

3. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-151/k të datës 22 shtator 2009, lidhur me plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës

Kryetari, e përshëndeti ministren e Drejtësisë, i njoftoi se takimi mbahet me qëllim që të gjendet zgjidhje për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës. Komisioni ka mbajtur disa takime radhazi, në të cilat shqyrtoheshin propozimvendimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe të kandidatëve të propozuar. Komisioni shqetësimet rreth propozimeve i

ka përcjellë në Kuvend duke vepruar në pajtim me Ligjin për Provimin e Jurisprudencës. Në vazhdim shtoi se në propozimet e fundit i kemi rekomanduar Kuvendit, e që është ndalur në Kryesi të Kuvendit, me arsyetimin se në rekomandim Ruzhdi Berisha nuk e ka marrë votën në seancën paraprahe. Po ashtu kandidatit, Bardhyl Hasanpapaj, nuk i dihet shtetësia. Në vazhdim njoftoi se Kuvendi ka rekomanduar, që nëse Iliriana Islami pranon të jetë gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të jetë edhe anëtare e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës. Për ta qartësuar këtë çështje ftoi ministren Nekibe Kelmendi ta marrë fjalën.

Nekibe Kelmendi, në fjalën e saj lidhur me formimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës tha "Ky është komision teknik profesional, jo komision politik". Ligji për Provimin e Jurisprudencës ka paraparë një mënyrë tjetër të emërimit të këtij komisioni. Në vazhdim shtoi se për të parën herë sot po dëgjon që Bardhyl Hasanpapaj nuk është shtetas i Kosovës. Ruzhdi Berisha është refuzuar me arsyetim se nuk i plotëson kushtet, duke shtuar se kjo nuk qëndron, sepse ju e keni dëshminë - të bashkangjitur për përvojën e tij të punës, duke filluar nga viti 1971 deri 1985, kur ka përfunduar në Gjykatën Supreme të Kosovës. Tha se lëvizjet e tij, as juridikisht e as faktikisht, nuk janë ndërprerje e punës, por ka vetëm avancime. Ndërsa lidhur me propozimin e Ilirjana Islamit, tha se nuk kemi të bëjmë me konflikt interesi. Si shembull e mori rastin e Rexhep Haxhimusës, i cili ushtron edhe funksion tjetër, prandaj as me Ligjin për konfliktin e interesit, as me Ligjin për provimin e jurisprudencës, nuk kemi të bëjmë me konflikt interesi.

Në vazhdim kërkoi nga Komisioni që çështja e formimit të këtij komisioni të zhbllokohet sa më parë, sepse kemi një numër të madh të personave që presin t'i nënshtrohen, e që i plotësojnë kushtet. Me arsyetimin e dhënë për kandidatët mbetet për propozimet të bëra.

Kryetari- Theksoi se Komisioni asnjëherë nuk e ka bllokuar punën, por ka qenë ai që një numër të madh rekomandimesh i ka përcjellë për Kuvend. Këto ishin rekomandime që kishin ardhur nga Ministria e Drejtësisë.

Çështjen, që ishte temë e diskutimit, e quajti ligjore, jo politike, duke shtuar se kandidati i propozuar, Bardhyl Hasanpapaj, nuk është shtetas i Kosovës dhe ceku se provimi i jurisprudencës është provim shtetëror dhe nuk mund të mbahet nga kandidatë, që nuk janë shtetas të Kosovës. Lidhur me propozimin e Ilirjana Islamit tha se ne, nuk e kemi kundërshtuar, por e kemi rekomanduar për Kuvend, mirëpo ajo ka qenë e padekretuar. Në momentin e dekretimit nga Presidenti nuk mund të merrte dekretimin pa hequr dorë nga funksioni në këtë komision të paraparë me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Kushtetutë. Lidhur me propozimin për Ruzhdi Berishën, Komisioni, por edhe Kuvendi, kanë pasur dilemë, sepse Ligji për Provimin e Jurisprudencës kërkon t'i ketë 10 viet përvojë në punë pa ndërprerë, si gjyqtar i lëndës edhe pse, ne, si Komision, e kemi rekomanduar në Kuvend.

Adem Salihaj, në fjalën e tij shprehu shqetësimin për zvarritjen e këtij procesi, duke përmendur rrjedhën e tij, shtoi se Ruzhdi Berisha nuk i plotëson kushtet në bazë të Ligjit për provimin e jurisprudencës, duke cekur se ne nuk i mohojmë aftësitë e tij profesionale, as përvojën, mirëpo Ligji kërkon 10 vjet përvojë në punë pa ndërprerë, ndërsa Iliriana

Islami i është rekomanduar Kuvendit, mirëpo dekretimi nga Presidenti, si gjyqtare nuk i lejon të jetë edhe anëtare e Komisionit të Jurisprudencës.

Armend Zemaj, në diskutimin e tij e rikujtoi se ka përkrahur edhe përbërjen e parë për formimin e komisionit, për hir që të mos zvarritet kjo çështje. Në vazhdim tha se nuk mund të bllokohet ky proces nëse ligji është pengesë.

Bajram Kosumi, Theksoi se ky proces është zvarritur shumë, përkundër përpjekjeve dhe punës që ka bërë Komisioni. Duke folur për kandidatët e propozuar tha se Komisioni ishte i mendimitë të mos votoheshin kandidatët, që edhe nga ana e Kuvendit nuk janë votuar. I propozoi ministres, që të bëjë propozime në vend të kandidatëve Ruzhdi Berisha dhe Iliriana Islami, ndërsa kandidati Bardhyl Hasanpapaj të votohet.

Pas një diskutimi që u zhvillua Komisioni vendosi të rekomandojë për shqyrtim në Kuvend propozime të njëjta edhe për kandidatët e propozuar, pasi që nuk kemi propozime të tjera, nga se ministrja qëndron pas kandidatëve të propozuar në propozimvendimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Procesverbalin e hartoi
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni